



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr Prot. Br.Prot Prot No
DPKI	06-798/20
Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
03	13.03.2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 09.03.2020, mori:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me Nr.AKK-DPKI-06-02/1903/19, për zyrtarin e lartë publik z. Fatmir Kurmehaj - Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Deçanit, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e hapur për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit me numër protokolli AKK-DPKI-06-02/1903/19, lidhur me zyrtarin e lartë z. Fatmir Kurmehaj, Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Deçanit, është zhvilluar procedura e paraparë sipas Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit ka hetuar këtë rast nën dyshimin për konflikt të interesit, sipas të cilit zyrtari i lartë z. Fatmir Kurmehaj, duke qenë Këshilltar Komunal i Kuvendit të Komunës së Deçanit ushtron njëkohësisht edhe veprimtarinë profesionale të Avokatisë.

Me rastin e konfirmimit të informacionit të mësipërm në institucionet përkatëse, Agjencia në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-06/2514/19, dhe se në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të kësaj shkrese, ai ka të drejtë të njoftohet gjerësisht me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin në fjalë.

Pas pranimit të kësaj shkrese nga pala, me kërkesë të tij është organizuar dhe mbajtur një takim në Agjencinë kundër Korrupsionit, me ç'rast zyrtari i lartë është njoftuar gjerësisht lidhur me faktin se, gjatë ushtrimit të funksionit publik në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, ai nuk mundet që krahas ushtrimit të funksionit publik të ushtroj veprimtarinë profesionale të avokatisë sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 12, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku thuhet se:

“ Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë veprimtari profesionale të avokatisë, noterisë, përmbaruesit privat, administratorit të falimentimit, ekspertit të licencuar, konsulentit ose agjentit të personave juridikë si dhe nuk mund të jetë i punësuar, me kohë të plotë, në një detyrë tjetër ”.

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtari i lartë z. Fatmir Kurmehaj, e ka kuptuar dhe është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se do të ndërmarr veprime konkrete në mënyrë që të shmang papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 10.01.2020, ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI-06/3327-1/19), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Fatmir Kurmehaj, ka paraqitur kërkesë pranë Odës së Avokatëve të Kosovës për pezullimin e ushtrimit të aktivitetit të avokatit.

Duke e parë situatën ku Oda e Avokatëve të Kosovës, nuk ka vendosur lidhur me kërkesën e palës për pezullim të aktivitetit, Agjencia kundër Korrupsionit me dt.06.02.2020, i është drejtuar kësaj të fundit që pa vonesë të ushtrojë kompetencat e saj ligjore dhe të vendos për kërkesën në fjalë. Përkundër kësaj, Oda e Avokatëve të Kosovës nuk e ka njoftuar Agjencinë për veprimet e ndërmarra lidhur me kërkesën e palës.

Ndërkohë Agjencia kundër Korrupsionit, ka pranuar informacione se zyrtari i lartë z. Fatmir Kurmehaj, ka dhënë dorëheqje nga funksioni publik i Këshilltarit Komunal të Kuvendit të Komunës së Deçanit. Për ta vërtetuar këtë informacion Agjencia kundër Korrupsionit me dt.05.03.2020, i është drejtuar Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Komunën e Deçanit, ku ka kërkuar konfirmimin e këtij informacioni dhe në të njëjtën ditë Agjencia ka pranuar konfirmimin zyrtar dhe aktin e dorëheqjes së z. Fatmir Kurmehaj nga posti i Këshilltarit Komunal në Kuvendin e Komunës së Deçanit.

Pas analizimit të dokumentacionit në dispozicion dhe konfirmimit të pranuar nga Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Komunën e Deçanit, Agjencia konstatoi se zyrtari i lartë z. Kurmehaj, ka dhënë dorëheqje të parevokueshme nga funksioni publik Këshilltar Komunal në Kuvendin e Komunës së Deçanit, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënpar. 1.4 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Në këtë mënyrë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtari i lartë, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.


Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtares së lartë publike
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shqipëri: Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit



The stamp is circular and purple, containing the text: "AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT", "REPUBLIC OF KOSOVO", and "1714 Korrupsionit".